



Republika e Kosovës - Република Косово - Republic of Kosovo
Qeveria – Влада – Government

Zyra e Kryeministrit / Канцеларија премијера / Office of The Prime Minister

Zyra e Komisionerit për Gjuhët / Канцеларија повереника за језике

Office of the Language Commissioner

RAPORT

Aktivitetet e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët
maj – nëntor 2013

Zyra e Komisionerit për Gjuhët gjatë kësaj periudhe kohore në përputhje me mandatin e saj ka zhvilluar aktivitete të njëpasnjëshme. Aktivitetet janë zhvilluar kryesisht në komponentin e informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve dhe institucioneve për të drejtat gjuhësore respektivisht obligimet gjuhësore që dalin nga korniza ligjore ekzistuese si dhe në komponentin e monitorimit të zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe shqyrtimit të ankesave të qytetarëve për shkelje të tij nga ana e institucioneve.

Informimi dhe dukshmëria e Zyrës

- Në periudhën maj-qershor është funksionalizuar faqja zyrtare e internetit e zyrës së Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) me adresë: www.komisioneri-ks.org ; www.poverenik-ks.org; www.commissioner-ks.org. Kjo faqe është e kompletuar dhe funksionon në të tre gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze.
- Me organizimin e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) është mbajtur punëtorja dyditore: “Zbatimi i politikave gjuhësore në kuadër të Zyrës së Informimit Publik dhe ueb-faqet e ministrive”. Në këtë punëtori kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore, përfaqësues të zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Qendrën Evropianë për Çështje të

Minoriteteve (ECMI) në Kosovë. Në këtë punëtori është bërë përmbledhja e rekomandimeve që kanë të bëjnë me standardizimin e termave dhe udhëzimet për përkthim.

- Me temën: “Bashkëpunimi në mes Institucioneve Qendrore dhe Lokale lidhur me procesin e kthimit dhe ri-integrimit dhe të drejtat gjuhësore” janë mbajtur pesë (5) takime regjionale në Pejë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan dhe Prishtinë. Në këto takime kanë marrë pjesë ZKGJ, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Punëve të Brendshme, (MPB), Ministria për Komuniteteve dhe Kthim, (MKK), Kryetarët e Komunës së Mitrovicës dhe Junikut, UNHCR, KAAD, OSBE etj. Të gjithë pjesëmarrësit së bashku kanë identifikuar hapat që duhet ndërmarrë drejt përmirësimit të gjendjes ku ka nevojë si dhe nevojën e ndryshimit të disa akteve nënligjore.
- Në kuadër të fushatës për vetëdijësimin publik në mbështetjen e zbatimit efektiv të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, ZKGJ në bashkëpunim me Programin për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe partnerin implementues MDA, ka organizuar pese (5) tryeza të rrumbullakëta në Regjionet: Prishtinë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Në këto tryeza të rrumbullakëta kanë marrë pjesë përfaqësues të komunave, shoqërisë civile, komunitetet jo shumicë si dhe përfaqësues të mediave lokale, ku është diskutuar kryesisht rreth vështirësive të zbatimit të ligjit për gjuhët dhe mbi rëndësinë dhe ndikimin e rrespektimit të përdorimit të barabartë të gjuhëve në punë.
- ZKGJ dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) që nga muaji shtator ka filluar me fushatën informuese për publikun me titullin “Gjuha juaj, e drejta juaj”. Fushata tri (3) mujore ka për qëllim vetëdijësimin e publikut për mekanizmat përkatës për mbrojtje të gjuhëve dhe ankesave si dhe për rolin e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët. Në kuadër të kësaj fushate janë përgaditur posterë, fletushka dhe dy (2) radio spote të prodhuara në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe rome, të cilat janë duke u transmetuar në tetë (8) radio stacione në Kosovë: Radio KIM, Radio Herc, Radio Blu Sky, Radio Gorazdevac, Radio Hayat, Radio Plus, Radio Dukagjini, Radio Ballkan.
- Janë organizuar pesë (5) tryeza të rrumbullakëta në komunat: Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe Gjilan për zyrtarë komunal, shoqërinë civile dhe përfaqësues të tjerë të komuniteteve jo-shumicë në nivel komunal. Në këto tryeza kryesisht është folur mbi rëndësinë e Rrjetit të politikave gjuhësore, domosdoshmërinë e forcimit të rolit dhe definimin e qartë të aktiviteteve të tyre lidhur me mbrojtjen e të drejtave gjuhësore.
- Përgatitja e Infofilmit -në bashkëpunim me UNDP dhe partnerin implementues MDA. Videoja e parë promovuese me kohëzgjatje prej 7’50” është transmetuar në RTK1 dhe RTK2 si dhe në televizionet lokale serbe.

Paraqitja mediale e Komisionerit për Gjuhët z. Slavisa Mladenovic:

- Gjatë kësaj periudhe Komisioneri për gjuhët ka qenë i ftuar në "Nedeljni Kolaz" program në gjuhën serbe në RTK1;

- Mysafir special në RTK2 si dhe në programin e mëngjesit në RTK2 me rastin e promovimit të infofilmit;
- Mysafir në programin e mëngjesit në TV Qendër në Cagllavicë;
- Pjesëmarrës i debatit të ciklit "Dialogu serbo -serb" në Qendrën Mediale në Cagllavicë me temën "Zbatimi i Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve në Kosovë",
- Mysafir në programin "Slobodno Srpski" , me mbulueshmëri të plotë në televizionet dhe radiot lokale me rastin e mbajtjes së tryezave të rrumbullakëta.

Aktivitetet në vazhdimësi lidhur me informimin dhe dukshmërinë e zyrës:

- *Përgatitja e Info filmit të dytë, i cili do të transmetohet në RTK1 dhe RTK2, si dhe në të gjitha televizionet lokale serbe.*
- *Përgatitja e spotit televiziv me gjatësi prej 25 " me qëllim të promovimit të zyrës dhe të drejtën e ankesës në rast të shkeljes të të drejtave gjuhësore.*
- *Përgatitja e një tryeze të rrumbullakët me përfaqësuesit e të gjitha mediave nacionale dhe lokale.*
- *Tregimi më i mirë gazetaresk lidhur me gjuhët planifikohet të mbahet në muajin dhjetor 2013.*

Monitorimi dhe ngritja e kapaciteteve

1. Monitorimi

- Komisioneri ka takuar Ministrin e MAP dhe zv. e MPJ me temë diskutimi, përdorimi i gjuhëve zyrtare nëpër institucione, respektivisht përmirësimi i formularëve dhe dokumenteve zyrtare.
- Janë mbajtur tre takime në Kuvendin e Kosovës, me Sekretarin e Kuvendit, Drejtorinë e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale dhe Drejtorinë për shërbime gjuhësore. Qëllimi i vizitës ka qenë monitorimi i përkthimeve dhe harmonizimi i ligjeve në gjuhët zyrtare.
- Është bërë hulumtimi për përdorimin e gjuhëve zyrtare në faqet e internetit të institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës. Raporti i brendshëm me të gjeturat dhe me rekomandimet u është dërguar institucioneve dhe i njëjti është prezantuar në punëtorinë e mbajtur në Prevallë para drejtorëve/zyrtarëve të lartë të informimit të këtyre institucioneve.
- Është mbajtur takimi me Institutin Albanologjik të Prishtinës, për mundësinë e bashkëpunimit në shumë fusha dhe ofrimin e lehtësirave për evitimin e gabimeve në normat gjuhësore nëpër institucione të ndryshme.
- Pas ankesave të bëra gjatë tryezave të rrumbullakëta nga qytetarët për gabimet e lëshuara në dokumentet e Gjendjes Civile, është vizituar Agjencia e Regjistrimit Civil. Ka vazhduar bashkëpunimi në mes dy institucioneve ku gjatë ndryshimit të Udhëzimit Administrativ për dokumentet e Gjendjes Civile, Zyra ka përgatitur raportin me rekomandimet ligjore dhe gjuhësore i cili është përfshirë në këtë dokument nga grupi punues.

- Janë angazhuar konsulentë gjuhësorë për gjuhën shqipe, serbe, turke dhe boshnjake me qëllim të finalizimit dhe eliminimit të gabimeve gjuhësore në të gjitha dokumentet e Gjendjes civile.
- Është përgatitur një dokument në formë tabele me të dhënat e komunave për përdorimin e gjuhëve zyrtare, bazuar në statutet dhe rregulloret e komunave.
- Me qëllim të monitorimit të implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve para dhe gjatë procesit zgjedhor është vizituar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për shërbime më cilësore dhe informacione të sakta këtij institucioni i është dhënë dokumenti zyrtar me të dhënat për gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar në komuna,
- Me qëllim të unifikimit të raporteve lidhur me të dhënat për komunat dhe me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve dhe bashkëpunimin në mes dy institucioneve në fushën e monitorimit të implementimit të Ligjit nëpër komuna, është vizituar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Është përpiluar draft raporti për monitorimin e faqeve zyrtare të internetit nëpër komunat e Republikës së Kosovës. Komunave iu janë dërguar shkresa përcjellëse me raport, për komentim.
- Vizitë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Qëllimi i vizitës ishte fillimi i bashkëpunimit për përmbushjen e obligimeve gjuhësore nga institucionet që mbikëqyren nga BQK-ja. Raporti me rekomandime është dërguar.
- Në vizitën e bërë në Ujësjellësin Rajonal Prishtina, është kërkuar që të bëhet harmonizimi i të dhënave dhe respektimi i gjuhëve zyrtare në punën dhe aktivitetet e kësaj kompanie publike.
- Vizitë në terminalin e ri të Aeroportit Ndërkombëtarë të Prishtinës ‘Adem Jashari’. Të gjitha mbishkrimet janë të paraqitura në gjuhët zyrtare që do të thotë se në parim është bërë harmonizimi i të dhënave në pajtueshmëri të plotë me Ligjin. Meqenëse mbishkrimet në gjuhën shqipe dhe serbe kishin disa gabime gjuhësore, në këtë takim u dakordua që lista me këto mbishkrime të dërgohet në Zyrën e Komisionerit për Gjuhët për përmirësimin e tyre.
- Është bërë vizitë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Qëllimi i vizitës ishte fillimi i bashkëpunimit në mes dy institucioneve në fushën e implementimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

2. ***Ngritja e kapaciteteve***

Është duke u zhvilluar projekti për mësimin e dy gjuhëve zyrtare në 10 komuna. Ky projekt është duke u zhvilluar me partnerin implementues, ECMI. Në kuadër të kësaj janë bërë dhjetë (10) vizita dhe takime me kryetarët e komunave (Prizren, Dragash, Kamenicë, Novobërdë, Obiliq, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Lipjan, Shtërpce).

Në Komunën e Fushë Kosovës këtij programi së bashku me Komisionerin z. Mladenovic, i ka bërë vizitë edhe Komisionerja e lartë e OSBE-së për Pakicat Kombëtare, znj Astrid Thor.

Në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në punën e Kuvendit të Kosovës, në partneritet me ECMI, janë duke u zhvilluar indikatorët matës për të bërë hulumtim për nivelin e zbatimit të Ligjit për gjuhët në këtë institucion.

Hetimet dhe ndërmjetësimi

Formulari final për ankesë është publikuar në faqen e internetit në format elektronik si dhe është shpërndarë në shumicën e komunave si formularë i shtypur në letër. Gjatë periudhës maj-nëntor, Zyra ka pranuar gjithsej shtatë (7) ankesa nga qytetarët. Tri (3) prej tyre kanë qenë të papranueshme ose jashtë juridiksionit të Zyrës, ndërsa dy (2) janë zgjidhur përmes ndërmjetësimi dhe dy (2) janë në proces për tu zgjidhur.

Nr.	Data	Parashtruesi i Ankesës	Institucioni, personat përgjegjës	Çështja
1	25.05.2012	Qendra edukativo-humanitare HERC	Ministria e Administratës Publike	Mosrespektimi i drejtë e gjuhëve zyrtare në dokumente, ligje, ueb faqe etj
2.	25.05.2012	KSAM	MTI	Mos përmirësimi i shenjave të komunikacionit
3.	25.05.2012	OJQ - 3E INSTITUT	Kuvendi i Kosovës	Mos respektimi i ligjit për gjuhët në ueb faqen zyrtare dhe në ligjet.
4.	20.12.2012	Qytetar nga Prishtina	MTI	Mosrespektimi i gjuhës turke në dokumentacionin e ARKB-së
5.	17.02.2013	Një familje	Komuna e Prishtinës	Formularët e shkruar vetëm në gjuhën shqipe
6.	22.03.2013	Qytetarët e fshatit Uglarë, Komuna e Fushë Kosovës	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	Vendimi për eksproprijim është ofruar vetëm në gjuhën shqipe.
7.	29.05.2013	Qytetar nga Prishtina	Komisioni për zhvillim ekonomik	Shkelja e te drejtave ligjore për përdorimin e gjuhëve në Ligjin nr. 04/L-181
8.	27.09.2013	Komuna e Shtërpces	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,	Vendimet dhe shkresat të dërguara vetëm në gjuhën shqipe

			Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës	
6.	30.09.2013	Këshilltar ligjor	Komuna e Mitrovicës	Refuzimi i një kërkesë në alfabetin cirilik
7.	23.10.2013	Qytetar nga Peja	Komuna e Pejës	Mos pranimi i dokumenteve në gjuhën boshnjake

Fig.1 Tabela e ankesave

Aktivite tjera

Zyra përfaqësohet në grupin punues për ballafaqim me të kaluarën dhe pajtim, ku mbahen takime të rregullta mujore.

Në bashkëpunim me OSBE është mbajtur punëtorja me temën: “Avancimi i funksionimit efektiv të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët”, në të cilën kanë marrë pjesë zyrtarët komunal të regjionin e Prishtinës.

Në bashkëpunim me ECMI është mbajtur konferenca me temën: “Mbështetja e qeverisjes efektive për komunitetet minoritare në Kosovë”

Rekomandimet

Për institucionet qendrore:

- Të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës duhet të marrin masat e nevojshme që të zbatojnë plotësisht Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në nivel qendror, duke rregulluar kështu çështjet e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe realizimin e të drejtave gjuhësore;
- Të bëhet ofrimi në gjuhën serbe i dokumentacionit publik, informacioneve dhe udhëzimeve të cilat janë publikuar në gjuhën shqipe. Publikimi të bëhet në të njëjtën kohë në gjuhët zyrtare;
- Të dhënat e ofruara në gjuhën serbe të jenë në nivelin e duhur kualitativ profesional sipas standardeve për të evituar kështu gabimet gjuhësore;

Për institucionet lokale:

- Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës duhet të marrin masat e nevojshme që të zbatojnë plotësisht Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në nivel lokal, duke rregulluar kështu çështjet e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe realizimin e të drejtave gjuhësore;
- Të bëhet ofrimi në gjuhën serbe, turke dhe boshnjake i dokumentacionit publik, informacioneve dhe udhëzimeve të cilat janë publikuar në gjuhën shqipe. Publikimi të bëhet në të njëjtën kohë në gjuhët zyrtare;
- Të dhënat e ofruara në gjuhën shqipe, serbe turke dhe boshnjake të jenë në nivelin e duhur kalitativ dhe profesional sipas standardeve, për të evituar kështu gabimet gjuhësore;

Për Agjencinë e Regjistrimit Civil:

- Agjensioni i Regjistrimit Civil duhet të marrë masat e nevojshme që të zbatoj plotësisht Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve për të rregulluar kështu çështjet e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe realizimin e të drejtave gjuhësore.
- Të bëhet ofrimi i dokumentacionit publik dhe informatave nëpër sportele të në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe si dhe në gjuhët zyrtare në nivel komunal në Komuna të caktuara.
- Të gjitha dokumentet e gjendjes civile që ARC lëshon për qytetarët e Republikës së Kosovës të jenë në dispozicion në gjuhët zyrtare , gjuhët zyrtare në nivel komunal si dhe në gjuhët në përdorim zyrtar në Komuna.
- Meqë gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre kanë statusin e barabartë si gjuhë zyrtare duhet të mundësohet edhe përfshirja e alfabetit cirilik në këto dokumente.
- ARC të mundësojë regjistrimin në formën origjinale të emrit dhe mbiemrit në pajtueshmëri me sistemin linguistik përkatës, qytetarëve të Republikës së Kosovës gjuha e të cilëve nuk është njëra nga gjuhët zyrtare ose gjuhë zyrtare në nivel komunal apo në përdorim zyrtar në komunë, në dokumentet e gjendjes civile.
- Të dhënat e ofruara dhe dokumentet e lëshuara të jenë në nivelin e duhur kalitativ profesional sipas standardeve për të evituar kështu gabimet gjuhësore.

Për Bankën Qendrore të Kosovës

- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës duhet të marrë masat e nevojshme që institucionet që ka nën mbikëqyrje të zbatojnë plotësisht Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve për të rregulluar kështu çështjet e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe realizimin e të drejtave gjuhësore.
- Të gjitha dokumentet e lëshuara nga kompanitë e sigurimeve duhet të janë në dispozicion në dy gjuhët zyrtare, në gjuhë shqipe dhe serbe (në shojcën 1 e keni një kopje të policës së sigurimit dhe letrës e cila i dedikohet të siguruarve që janë vetëm në gjuhën shqipe dhe angleze).

Sfidat

- Mos aprovimi i rekomandime të Bordit nga Qeveria
- Numri I vogël i përkthyesve nëpër institucione
- Mungesë e profesionalizmit të përkthyesve dhe mungesë e lektorëve
- Buxheti jo i mjaftueshëm për kontraktim të kompanive
- Mungesë e kapaciteteve në implementim të Ligjit për Gjuhët
- Mungesë të stimulimit për përkthyesit
- Mos definimi i qartë i pozitave për përkthyesit
- Mbingarkesë e përkthimeve (që ndikon te niveli profesional i përkthimeve)